



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 17.01.2019

MBI

**ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U PAGUHET
PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 10 të Ligjit Nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; VKM-së Nr. 687, datë 22 Nëntor 2017 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve egzistues me përparësi”; nenit 15; nenit 21; nenit 22 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve, lidhur me “Çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve egzistues me përparësi për vitin 2019”,

Konstatoi se:

- Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 687, datë 22 Nëntor 2017, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve egzistues me përparësi.
- Metodologjia për llogaritjen e këtij çmimi është: “Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.
- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) për vitin 2018 sikurse paraqitur në tabelën më sipër rezulton në vlerën 51 Euro/MWh.
- Sipas VKM-së së sipërpërmendur, me normë mesatare të shkëmbimit Euro/Lekë të vitit të fundit kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit Euro/Lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2018. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e

Shqipërisë mbi kursin e këmbimit Lekë/EUR, për çdo ditë të vitit 2018 rezulton se kursi mesatar i këmbimit për vitin 2018 rezulton në vlerën 127.575 Lekë/EUR.

- ERE rezervon të drejtën që të axhustojë llogaritjet e bëra në rast se kursi i këmbimit Lekë/EUR që do të publikohet në Raportin Vjetor 2018 të Bankës së Shqipërisë (gjatë muajve në vazhdim) ndryshon nga çmimi i llogaritur deri tani.
- Nga llogaritjet e bëra, çmimi i llogaritur sipas formulës së cituar në metodologji ndodhet brenda limiteve të përcaktuar në paragrafet 2.ç dhe 2.d, të VKM-së Nr. 667, datë 22.11.2017 të cilat përcaktojnë edhe kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi.
- Sipas parashikimeve të gërmës “d” të nenit 2 të VKM-së së sipërpërmendur, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019, do të jetë 8.4582 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve egzistues me përparësi për vitin 2019 të jetë 8.4582 Lekë/kWh.
2. ERE do të korrigjojë llogaritjet e bëra në rast se kursi i këmbimit Lekë/EUR që do të publikohet në Raportin Vjetor 2018 të Bankës së Shqipërisë, (gjatë muajve në vazhdim) ndryshon nga çmimi i llogaritur deri tani.
3. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë prodhuesit egzistues me përparësi për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI